



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETARI

Nr. 2834 Prot

Shkodër, më 22.02 .2019

VENDIM

Nr. 31 datë 22.02 .2019

**“ PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL,  
PËR VITIN 2019 NË INSTITUCIONIN E BASHKISË SHKODËR , PJESË E  
SHËRBIMIT CIVIL ”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 8; gërma b, neni 9, të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar; Ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.108, datë 26.02.2014 “Për Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil.”; Vendimit nr. 06 dt. 03.01.2019 “Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër ”

VENDOSA :

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim në administratën e Bashkisë Shkodër, pjesë e shërbimit civil është gjithsej, sipas kategorive të mëposhtme:
  - Për kategorinë e mesme drejtuese 1 ( një)
  - Për kategorinë e ulët drejtuese 4 ( katër)
  - Për kategorinë ekzekutive 6 ( gjashtë )
2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, në kategorinë ekzekutive, janë si më poshtë:
  - Shkenca Juridike;
  - Shkenca Ekonomike;
  - Shkenca Kompjuterike;
  - Shkenca Shoqërore;
  - Shkenca Sociale;
  - Shkenca Mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
  - Inxhinieri;
  - Arkitekturë;
  - Gjeodezi;
  - Shkenca Edukimi;

3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerezore, në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

